



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 837/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fatbardha Selmani kandidate për asamble komunale nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Fatbardha Selmani kandidate për asamble komunale nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gjilan.

### **Arsyetim**

Me datën 12.11.2013, Fatbardha Selmani kandidate për asamble komunale nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjilan ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se në QV nr.0404D/01R në fshatin Bresalcë dyshoj se është bërë manipulim dhe vjedhja e votave në këtë qendër, andaj kërkoj nga PZAP-i që të bej hapjen e kutisë së votimit për manipulimin e votave, thuhet në pretendimet e ankuesit

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet e Fatbardha Selmanit kandidate për asamble komunale nga radhët e PDK-së nuk qëndrojnë ngase nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindse me të cilën mund të vërtetohen pretendimet ankimore. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante , andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 837/2013 më datën 12.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.